

5 - Çfarë ofron?

Veprimi Katolik është “mënyra e vetme ministeriale për laikët në Kishë”. (Paolo VI, 25 Prill 1977).



- Ofron një formim personal dhe shpirtërorë për ungjillizimin në të gjitha famullitë, deri sa Veprimi Katolik për ungjillizimin e laikëve të jetë sa më efikas e të realizohet në një klimë bashkimi e pasioni për të qënë apostull.
- I ofron famullive itinerar formimi që janë të bashkëngjitura me Fjalën e Zotit, programet e Katekizimit, Magjisterin e Kishës e të vetë jetës kishtarë duke kërkuar të bashkojë besimin me jetën e përditshme të besimtarit.

6 – Si organizohet?



- Veprimi Katolik i organizon besimtarët laikë në grupe famullitare ku bashkëndajnë eksperiencë besimi, bashkëndarje të jetës së përditshme e të gjejnë shtytjen për të qënë kripa e botës dhe drita e tokës.
- Nëpërmjet itinerareve të saj edukon fëmijët, të rinjtë e të rriturit të jenë dëshmitarë të dashurisë së Hyjit. Sigurohet me një metodë që kërkon formimin dhe bashkëbisedimin shpirtëror të besimtarëve dhe i jep guximin të angazhohen në transformimin e realitetit shoqëror.



Veprimi Katolik Shqiptar

1- Cili është Veprimi Katolik Shqiptar?



Është një grup besimtarësh të kërkuar nga vetë Kisha për Ungjillizimin e njerëzve dhe realiteteve ku është vendosur famullia. Është e lidhur ngushtë me Ipeshkvin e Dioqezës ku është formuar. Ofron një eksperiencë jete dhe besimi e jetuar personalisht por dhe në bashkësi nëpërmjet një propozim formimi që i jep rëndësi jetës, e shndritur nga Ungjilli dhe e orientuar drejt misionit me një përgjegjësi të përbashkët.

2- Cili është misioni i tij?



Një shkollë për dishepuj misionar që i jep guximin besimtarëve “të dalin” e të Ungjillizojnë personalisht duke u mishëruar çdo ditë në realitetin e përdhshëm e që ndihmojnë të japin drejtime të përbashkëta për misionin. Besimtarë të vëmendshëm ndaj nevojave e ndaj urgjencave të botës, të gatshëm për tu angazhuar për ndryshimin dhe ndërtimin e një shoqërie e mbushur plot me dashuri.

3 – Ku?



Veprimi Katolik jeton brënda famullisë dhe dioqezës. Organizohet në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Në famulli punon me programet baritore të propozuara nga dioqeza. Veprimi Katolik vepron me qëndrueshmëri dhe besnikëri në shërbimin e formimit të besimtarit që është po i njëjti formim që kërkohet nga vetë Dioqeza.

4 – Kush mund të jetë pjesë e saj?



Veprimi Katolik është për të gjitha grup moshat, për fëmijët, të rinjtë, të rriturit, për familjet, për besimtarët e famullive e për ata të dioqezës, duke përfshirë Ispeshkvinjtë, famullimtarët dhe asistentët.



Veprimi Katolik nuk mund të qëndrojë larg popullit, sepse vjen nga populli e duhet të qëndrojë në mes të popullit. Duhet të shtohemi sa më shumë në popull si Veprimi Katolik. Nuk është për arsye rritje e numrit, por është për të treguar të vërtetën dhe karizmën e saj. Të gjithë pjestarët e Veprimit Katolik janë të gjithë misionar energjikë.



Fëmijët Ungjillizojnë fëmijët, të rinjtë Ungjillizojnë të rinjtë, të rriturit Ungjillizojnë të rriturit e kështu me rradhë. Nuk ka vepër më të bukur sesa të tregosh që është e mundur të jetosh në gëzimin e besimit.